



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 27

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E premte, 2 mars 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 23/2018, datë 26.2.2018	Për zgjedhjen e kryetarit të Komisionit të Prokurimit Publik..... 2031
Vendim i Kuvendit nr. 24/2018, datë 26.2.2018	Për zgjedhjen e një anëtari të Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri..... 2031
Vendim i Kuvendit nr. 25/2018, datë 26.2.2018	Për zgjedhjen e një anëtari të Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri..... 2031
Vendim i Kuvendit nr. 26/2018, datë 26.2.2018	Për zgjedhjen e një anëtari të Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri..... 2031
Vendim i Kuvendit nr. 27/2018, datë 26.2.2018	Për zgjedhjen e një anëtari të Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri..... 2032
Vendim i Kuvendit nr. 28/2018, datë 26.2.2018	Për zgjedhjen e një anëtari të Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri..... 2032
Vendim i Kuvendit nr. 29/2018, datë 26.2.2018	Për zgjedhjen e një anëtari të Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri..... 2032
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 98, datë 23.2.2018	Për një shtesë në vendimin nr. 640, datë 7.9.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin e sporteve të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në administrim të Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integuara (ADISA)”, të ndryshuar..... 2032
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 99, datë 23.2.2018	Për një ndryshim në vendimin nr. 982, datë 25.10.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kryetarit dhe emërimit e anëtarëve, përfaqësues të pushtetit qendror, në Këshillin Drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit” 2033

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 100, datë 23.2.2018	Për kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Tiranë, të pronës nr. 75, me emërtim "AISM, reparti ushtarak nr. 6002", me vendndodhje në Linzë, Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar.....	2033
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 101, datë 23.2.2018	Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të agjencive private të punësimit.....	2035
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 102, datë 23.2.2018	Për lirim, mandatimin dhe rimandatimin e disa anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit.....	2036
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 106, datë 23.2.2018	Për miratimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së grantit nr. TF0A1769, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si administratore e fondeve të grantit të akorduar nga Fondi i Mirëbesimit me Shumë Donatorë, për financimin e projektit të zbatimit të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse në Shqipëri (EITT).....	2037
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 107, datë 23.2.2018	Për disa ndryshime në vendimin nr. 42, datë 17.1.1998, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit", të ndryshuar"	2040
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 108, datë 23.2.2018	Për një ndryshim në vendimin nr. 848, datë 7.12.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e shoqërisë "Albgaz" sh.a dhe përcaktimin e autoritetit publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive "Albpetrol" sh.a dhe "Albgaz" sh.a."	2041
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 111, datë 23.2.2018	Për krijimin dhe funksionimin e fondit social.....	2041
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 23.2.2018	Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore "doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "profesor i asociuar" dhe "profesor"	2042
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 114, datë 23.2.2018	Për përcaktimin e rregullave për emërimin, shkarkimin dhe shpërblimin e kryetarit dhe të anëtarëve të Këshillit Drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës.....	2049

**VENDIM**

Nr. 108, datë 23.2.2018

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 848, DATË 7.12.2016, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, "PËR KRIJIMIN E
SHOQËRISË "ALBGAZ" SHA DHE
PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT
PUBLIK, QË PËRFAQËSON SHETETIN
SI PRONAR TË AKSIONEVE TË
SHOQËRIVE "ALBPETROL" SHA
DHE "ALBGAZ" SHA"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 36, pikat 2 e 5; 50, pikat 2 e 4, 57 e 80, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", dhe të nenit 4, të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995, "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 3, e vendimin nr. 848, datë 7.12.2016, të Këshillit të Ministrave, riformulohet, si më poshtë:

3. Autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si pronar të 100% të aksioneve të shoqërisë "Albgaz" sh.a., është ministria përgjegjëse për infrastrukturën."

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe shoqëria "Albgaz" sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

VENDIM

Nr. 111, datë 23.2.2018

**PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN
E FONDIT SOCIAL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 24, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", dhe të pikës 4, të nenit 47, të ligjit nr. 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Brendshëm dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e fondit social të mekanizmit financiar, nëpërmjet të cilit sigurohet mbështetje financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore, me qëllim përmirësimin e standardeve e të kapaciteteve administruese të shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror, planifikimin e krijimit e shërbimeve të reja, si dhe zhvillimin e politikave sociale.

2. Fondi social krijohet me burime financiare, nga:

a) fondet e kushtëzuara që akordohen nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale;

b) fondet nga buxhetet e njërive të vetëqeverisjes vendore, të parashikuara për shërbimet shoqërore;

c) të ardhurat nga organizatat jofitimprurëse, individët e bizneset, si dhe donatorë të huaj e lokalë;

ç) tatifat për shërbimet për përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

3. Mekanizmi i financimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror ndjek hapat e përcaktuar më poshtë, në përputhje me ciklin e buxhetit vjetor dhe të programit buxhetor afatmesëm.

4. Programimi dhe financimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror

4.1. Njësia e vetëqeverisjes vendore vlerëson nevojat për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel vendor, në përputhje me planin strategjik të zhvillimit dhe me programin buxhetor afatmesëm.

4.2. Njësia e vetëqeverisjes vendore vlerëson kapacitetet financiare dhe burimet njerëzore që mbështesin ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel vendor. Deri në miratimin e standardeve kombëtare, bashkitë duhet të marrin



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 239

Tiranë – E martë, 13 dhjetor 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe	
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 835, datë 23.11.2016	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 395, datë 29.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës në administratën shtetërore dhe institucionet e tjera publike”.....	24359
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 845, datë 7.12.2016	Për miratimin e Raportit Kombëtar për zbatimin e konventës ndërkombëtare të OKB-së “Për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punëtorëve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre”.....	24359
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 846, datë 7.12.2016	Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të Policisë së Shtetit për menaxhimin elektronik të gjobave (E-gjoba).....	24339
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 847, datë 7.12.2016	Për kalimin në pronësi, nga Ministria e Kulturës (Qendra Ndërkombëtare e Kulturës “Arbnori”) të Bashkia Tiranë, të pronës me numër pasurie 1/53, të ndodhur në zonën kadastrale 8160, me sipërfaqe trualli dhe ndërtese 4294 m ² , dhe për një ndryshim në vendimin nr. 286, datë 8.8.1991, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Qendrës Ndërkombëtare të Kulturës”.....	24400
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 848, datë 7.12.2016	Për krijimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. dhe përcaktimin e Autoritetit Publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive “Albpetrol” sh.a. dhe “Albgaz” sh.a.....	24402
	Korrigjim gabimi në vendimin nr. 756, datë 26.10.2016, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 280, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesa anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 205/2016, datë 3.11.2016.....	24403

**VENDIM**

Nr. 848, datë 7.12.2016

**PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË
“ALBGAZ” SHA DHE PËRCAKTIMIN
E AUTORITETIT PUBLIK QË
PËRFAQËSON SHTETIN SI PRONAR
TË AKSIONEVE TË SHOQËRIVE
“ALBPETROL” SHA DHE
“ALBGAZ” SHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 36, pikat 2 e 5, 50, pikat 2 e 4, 57 e 80, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, dhe të nenit 4, të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995, “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë dhe të ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkëputjen e njësisë së gazit nga shoqëria “Albpetrol” sh.a. dhe krijimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a., me kapital 100 % shtetëror.

2. Shoqëria “Albgaz” sh.a., duhet të funksionojë si një operator i kombinuar duke kryer veprimtarinë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes të gazit natyror.

Kapitali fillestar për krijimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a., të jetë 359 068 000 (treqind e pesëdhjetë e nëntë milionë e gjashtëdhjetë e tetë mijë) lekë. Kjo vlerë e kapitalit fillestar përfaqëson vlerën me të cilën do të zvogëlohet kapitali i shoqërisë “Albpetrol” sh.a., pas shkëputjes së njësisë së gazit, në përputhje me urdhrin nr. 550/3, datë 5.5.2016, të ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, “Për sistemimin e kapitalit të Albpetrol sh.a.”.

3. Autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si pronar të 100% të aksioneve të shoqërisë “Albgaz” sh.a., është Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

4. Ministria e Energjisë dhe Industrisë ushtron të drejtat mbi shoqërinë “Albgaz” sh.a., në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, dhe fushën e tij të përgjegjësisë shtetërore.

Faqe | 24402

5. Autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërisë “Albpetrol” sh.a., është Ministria e Energjisë dhe Industrisë.

6. Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe ministri i Energjisë dhe Industrisë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ndjekin procedurat e nevojshme, për:

a) regjistrimin e zvogëlimit të kapitalit të shoqërisë “Albpetrol” sh.a., transferimin e vlerës së kapitalit të zvogëluar te shoqëria “Albgaz” sh.a., si dhe përmylljen e procedurave për regjistrimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a., në Qendrën Kombëtare të Biznesit;

b) emërimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërive “Albgaz” sh.a. dhe “Albpetrol” sh.a., duke respektuar kufizimet e përcaktuara në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

7. Me regjistrimin në QKB, shoqëria “Albgaz” sh.a., të aplikojë pranë Entit Rregullator të Energjisë për certifikim, si operator transmetimi, sipas procedurave të përcaktuara në nenin 37, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe për pajisjen me licencë për transmetimin e shpërndarjen e gazit natyror, në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenet 22, 23 dhe 24, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

8. Aktiviteti i shoqërisë “Albgaz” sh.a., për periudhën nga krijimi i saj deri më 31 dhjetor 2017, të financohet nëpërmjet fondeve që do të sigurohen nga marrëveshja e huas, e lidhur me shoqërinë “Albpetrol” sh.a. dhe/ose fondet që siguron mbi bazën e marrëveshjeve me institucione financiare dhe/ose donatore vendas apo ndërkombëtare.

9. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe shoqëria “Albpetrol” sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**